

Version i avancuar i paredaktuar

Komiteti i të Drejtave të Njeriut

Distr: I Përgjithshëm
29 tetor 2023
Anglisht

**Opinion i miratuar nga Komiteti sipas nenit 5 (4) të
Protokollit Fakultativ, në lidhje me komunikimin Nr.
3602/2019*,****

<i>Komunikim i paraqitur nga:</i>	Daniel Faslliu, Marjeldo Rexha, Hajrije Rexha (përfaqësuar nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve dhe Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS))
<i>Viktimat e pretenduar:</i>	Ankuesit
<i>Shteti palë:</i>	Shqipëria
<i>Data e komunikimit:</i>	2 Maj 2018 (paraqitja fillestare)
<i>Referencat në dokumente:</i>	Vendimi i marrë në përputhje me rregullin 92 të rregullores së procedurës së Komitetit, i dërguar shtetit palë më 13 maj 2019 (nuk është lëshuar në formë dokumenti)
<i>Data e miratimit të Opinionit:</i>	29 Tetor 2024
<i>Objekti:</i>	Regjistrimi i lindjes
<i>Cështje procedurale:</i>	Kompetenca <i>ratione temporis</i> ; niveli i pretendimeve themelore
<i>Cështjet e themelit:</i>	Regjistrim i lindjes; e drejta për të fituar shtetësinë; diskriminim në bazë të prejardhjes etnike; njohja si persona përpara ligjit; e drejta për jetë familjare; e drejta për të marrë pjesë dhe kontribuar në çështjet publike
<i>Nenet e Paktit:</i>	16, 17, 24 (1-3), 25 dhe 26
<i>Nenet e Protokollit Fakultativ:</i>	2 dhe 3

Ankuesit në këtë komunikim janë Daniel Faslliu, lindur në Lamia, Greqi, në Shkurt 2014; Marjeldo Rexha, lindur në Athinë, Greqi, në Gusht 2002, dhe Hajrije Rexha, lindur në

* Miratuar nga Komiteti në seancën e tij të 142-të (14 tetor – 7 nëntor 2024)

** Në shqyrtimin e komunikimit morën pjesë anëtarët e mëposhtëm të Komitetit:

Tania Maria Abdo Rocholl, Wafaa Ashraf Moharram Bassim, Rodrigo A. Carazo, Mahjoub El Haiba, Laurence R. Helfer, Carlos Gomez Martinez, Bacre Waly Ndiaye, Marcia V.J. Kran, Hernan Quezada Cabrera, José Manuel Santos Pais, Tijana Surlan, Kobuyah Tchamdja Kpatcha, Koji Teraya, Hélène Tigroudja dhe Imeru Tamerat Yigezu.

Athinë, Greqi, në Gusht 2002. Ankuesit deklarojnë se kombësia e tyre është shqiptare, por se ata janë në rrezik të pashtetësisë. Ankuesit pretendojnë se mosveprimi i autoriteteve shtetërore të shtetit palë për të regjistruar lindjen e tyre përbën shkelje të të drejtave të tyre sipas neneve 16, 17, 24 (1-3), 25 dhe 26 të Paktit. Protokolli Fakultativ hyri në fuqi për shtetin palë në 4 janar 2008. Ankuesit përfaqësohen nga avokatë.

Faktet e paraqitura nga ankuesit

2.1 Ankuesit deklarojnë se ata i përkasin komunitetit rom. Në kohën e lindjes së tyre, prindërit e tyre shqiptarë jetonin në Greqi, pa status të ligjshëm qëndrimi. Ata vërejnë se neni 7 i ligjit Shqiptar nr. 8389 “Për shtetësinë” parashikon se “Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare.” Megjithatë, ata pretendojnë se në praktikë fitimi i shtetësisë sipas legjislacionit vendas është efektiv vetëm në bazë të regjistrimit të lindjes së një fëmije. Regjistrimi i lindjeve në shtetin palë rregullohet me Ligjin nr. 10129 “Për Gjendjen Civile” i vitit 2009. Sipas ligjit prindërit kanë përgjegjësinë kryesore për regjistrimin e lindjes së fëmijëve të tyre. Në rast se prindërit nuk regjistrojnë lindjen, i takon institucioneve shtetërore ta bëjnë atë. Sipas nenit 38 (1) të Ligjit për Gjendjen Civile, regjistrimi i lindjes së një fëmije në shtetin palë kërkon paraqitjen e një certifikate lindjeje të lëshuar nga institucioni përkatës ku ka ndodhur lindja. Certifikata duhet të paraqitet në Zyrën e Gjendjes Civile, pra në zyrën ku është e regjistruar nëna e fëmijës ose në zyrën më të afërt me vendbanimin e nënës. Në rast se nëna e ka lindur fëmijën jashtë institucioneve spitalore, lindja mund të vërtetohet me raport mjekësor. Në raste të tjera, kur prindërit nuk mund të vërtetojnë një lindje me një dokument të tillë ose kur dokumenti nuk është në formatin e kërkuar, ata duhet të fillojnë procedurën gjyqësore për vërtetimin e faktit të lindjes. Ligji nuk parashikon asnjë kufizim kohor për regjistrimin e lindjes, por nxit regjistrimin e hershëm. Procesi i regjistrimit të lindjes mund të jetë kompleks dhe i vështirë për t'u aksesuar, veçanërisht për ata që nuk kanë dokumentet e kërkuara ose janë veçanërisht të cenueshëm.

2.2 Ankuesit deklarojnë se për fëmijët e lindur jashtë territorit të shtetit palë nga prindër që janë shtetas shqiptarë, deri në janar 2017, kishte dy mënyra për të regjistruar lindjen e një fëmije. (a) regjistrimi i lindjes pranë autoriteteve konsullore shqiptare në vendin ku lind fëmija, duke paraqitur një certifikatë lindjeje nga spitali në të cilin fëmija ka lindur, që përmban të dhëna për datën e lindjes, vendin e lindjes, gjininë dhe emrin e nënës. (b) Nëse fëmija ka lindur jashtë shtetit palë dhe ka qenë i regjistruar në një zyrë të gjendjes civile në një vend të huaj, prindërit mund të regjistrojnë lindjen e fëmijës drejtpërdrejt në zyrën e tyre të gjendjes civile në shtetin palë, pasi të kenë hyrë në territorin shqiptar. Në një rast të tillë, certifikata e lindjes duhet të jetë në formën e përcaktuar me ligj, d.m.th., një certifikatë e legalizuar, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar. Në dhjetor 2016, u miratua ligji i ri për ndryshimin e Ligjit për Gjendjen Civile¹. Sipas ndryshimeve, duke qenë se nga viti 2017 të gjitha lindjet e fëmijëve duhet të regjistrohen në Shqipëri, shërbimet konsullore shqiptare nuk kanë më kompetencë për të regjistruar lindjet.

2.3 Ankuesit vënë në dukje se fëmijët që lindin në Greqi nga prindër që nuk janë shtetas, përgjithësisht, e regjistrojnë lindjen e tyre në Greqi bazuar në një "certifikatë të amësisë" të lëshuar nga spitali. Megjithatë, prindërit, si ata të autorëve, që qëndrojnë në Greqi pa leje qëndrimi, pajisen vetëm me një dokument që vërteton faktin e lindjes. Ky dokument është i paplotë pasi nuk tregon emrin e fëmijës dhe i referohet fëmijës si "ako" ("pa emër"). Prindërit pa status të ligjshëm qëndrimi nuk lejohen t'i vendosin fëmijës së tyre një emër në certifikatë pasi ata nuk kanë të drejtë ligjore të qëndrojnë në Greqi. Para datës 1 janar 2017, disa prindër shqiptarë u përpoqën të regjistronin lindjen e fëmijëve të tyre në shërbimet konsullore shqiptare në Greqi, pavarësisht certifikatës greke të paplotë. Shërbimet konsullore shqiptare refuzuan regjistrimin në bazë të certifikatës së paplotë të lindjes dhe i'u kërkuan prindërve të paraqitnin dokumentin e paplotë të lindjes pranë

¹ Ligji nr. 134 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129”, datë 11 maj 2009’.

Ministrisë të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Shëndetësisë greke për të siguruar vulat e nevojshme për legalizimin e dokumentit. Autoritetet greke nga ana e tyre refuzuan legalizimin e “certifikatave të lindjes ako” pasi ato ishin të paplota. Megjithëse ankuesit janë në dijeni të rasteve kur autoritetet greke legalizuan në mënyrë të jashtëzakonshme një certifikatë lindjeje të tillë jo të plotë, autoritetet shqiptare do të refuzonin të regjistronin lindjen, sepse dokumenti ende nuk tregon emrin e fëmijës. Prindërit që janë në të njëjtën situatë me atë të ankuesve, pra prindërit fëmijët e të cilëve kanë lindur në Greqi, ndërkohë që prindërit nuk kishin status të ligjshëm të qëndrimit në atë vend, të cilët u përpoqën të regjistronin fëmijën e tyre në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri, hasën të njëjtat pengesa, me vështirësinë e shtuar se nuk kishin mundësi as të përpiqeshin t’i legalizonin dokumentet greke nga autoritetet greke, pasi ishin larguar nga Greqia. Ankuesit pohojnë se romët janë prekur në mënyrë disproporcionale nga problemi i regjistrimit të lindjeve të huaja në shtetin palë pasi: Romët mund të kenë më shumë gjasa të lëvizin në Greqi në mënyrë të parregullt për shkak të varfërisë së tyre të jashtëzakonshme në Shqipëri; Romët duket se janë më rregullisht në shënjestër të dëbimeve nga Greqia; Romët janë përgjithësisht më të varfër se jo-romët dhe pa sigurim shëndetësor nuk mund të paguajnë shpenzimet e spitalit në Greqi dhe përballen me pengesa që i pengojnë të sigurojnë dokumentacionin që u nevojitet²; dhe duke qenë se romët janë përgjithësisht më të varfër, pasi kthehen në Shqipëri, është jashtëzakonisht e vështirë për ta që të kthehen në Greqi për të përmbushur formalitetet e nevojshme për të siguruar legalizimin e dokumenteve të lindjes të lëshuara në Greqi.

2.4 Ankuesi i parë ka lindur në shkurt 2014 në Greqi, ku prindërit e tij shqiptarë jetonin pa status të ligjshëm qëndrimi. Lindja e tij u regjistrua në Zyrën e Gjendjes Civile në Greqi, por autoritetet refuzuan të përcaktonin emrin e tij në certifikatë pasi prindërit e tij nuk kishin status të ligjshëm qëndrimi në Greqi. Gjithashtu, certifikata e regjistrimit nuk kishte vulën përkatëse sipas ligjit dhe as vulën apostile. Këto fakte i penguan prindërit e tij të regjistronin lindjen në Regjistrin Shqiptar. Ankuesi i parë u rikthye në Shqipëri në vitin 2014, por për shkak se lindja e tij nuk ishte regjistruar në gjendjen civile, ai nuk mund të frekuentonte kopshtin apo shkollën ose të pranohej nga institucionet shëndetësore.

2.5 Ankuesi i dytë dhe i tretë, të cilët janë binjakë, dhe kanë lindur në vitin 2002 në Athinë, ku prindërit e tyre shqiptarë jetonin pa status të ligjshëm qëndrimi. Për shkak se nuk kishin të ardhura për të paguar tarifat e spitalit prej 1000 euro, prindërit u larguan nga spitali para se të pajiseshin me certifikatën mjekësore të lindjes. Në një datë të papërcaktuar, prindërit e ankuesve të dytë dhe të tretë shkuan në zyrën e gjendjes civile greke në Athinë dhe kërkuan një certifikatë lindjeje për fëmijët e tyre. Më pas, lindjet u regjistruan dhe zyra lëshoi vërtetime pa përcaktuar emrat e ankuesve, duke i regjistruar vetëm si "binjaku i parë" dhe "binjaku i dytë". Prindërve iu tha se duke qenë se nuk kishin status të ligjshëm qëndrimi në Greqi, nuk mund të regjistronin emrat e fëmijëve të tyre dhe ata mund të pajiseshin vetëm me këto certifikata jo të plota, të cilat nuk i lejonin të regjistronin lindjen e ankuesve në shtetin palë, pasi dokumentet nuk përputhen me kërkesat e legjisllacionit vendas. Në momentin e paraqitjes së ankesës, ankuesi i dytë dhe i tretë ishin 15 vjeç dhe jetonin në Shkodër, Shqipëri, por nuk mund të ndiqnin shkollën ose të përfitonin nga shërbimet sociale dhe shëndetësore pasi nuk kishin qenë dhe nuk mund të regjistroheshin pranë autoriteteve shqiptare.

2.6 Ankuesit vërejnë se në mungesë të një certifikate lindjeje në përputhje me formën e kërkuar sipas legjisllacionit të brendshëm, një alternativë është fillimi i procedurës gjyqësore civile sipas nenit 45 të Ligjit për Gjendjen Civile përmes një kërkesëpadie për plotësimin e të dhënave të certifikatës së lindjes. Megjithatë, autorët pretendojnë se nuk mund të përfitojnë nga ky proces pasi kanë lindur jashtë vendit dhe gjykatat e shtetit palë kanë pohuar vazhdimisht, në raste të tilla si ato të tyre, se gjykatat e brendshme nuk kanë juridiksion për të plotësuar ose korrigjuar certifikatat e lëshuara

² Ankuesit i referohen CERD, vëzhgimet përmbyllëse mbi Greqinë, CERD/C/GRC/CO/22-23, 2 tetor 2016 dhe CESCR, vëzhgime përmbyllëse mbi Greqinë, E/C.12/GRC/CO/2, 27 tetor 2015

nga autoritetet e huaja³.

2.7 Ankuesit vërejnë se është gjithashtu e mundur të kundërshtohet refuzimi i autoriteteve konsullore ose Zyrës së Gjendjes Civile për të regjistruar lindjen e një fëmije të lindur në Greqi nga prindër shqiptarë pa dokumente, nëpërmjet proceseve gjyqësore. Ata theksojnë se Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) pati sukses në një rast të tillë. Megjithatë, procedura gjyqësore zgjati dy vjet e gjysmë dhe ankuesit theksojnë se nuk kanë mjete ekonomike për të paguar për një procedurë të tillë dhe pretendojnë se nuk ka ndihmë juridike për ta. Ata theksojnë se në bazë të ligjit nr. 10039 "Për ndihmën juridike" një person duhet të provojë se përfiton ndihmë sociale për të siguruar ndihmë juridike, duke i bërë të papërshtatshëm personat pa dokumentacion të përfitojnë ndihmë juridike. Më tej ata pretendojnë se zgjatja e tepërt e procedurave nuk është në përputhje me të drejtën për regjistrim "të menjëhershëm" të lindjes sipas nenit 24 të Paktit. Ata vërejnë se në vitin 2018 shteti palë ka miratuar ligjin nr. 111/2017 'Ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti'; megjithatë, legjislacioni i ri ende nuk është zbatuar pasi aktet e ndryshme nënligjore të kërkuara për zbatim nuk janë miratuar.

2.8 Ankuesit nuk kanë paraqitur ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, pasi argumentojnë se që një ankim kushtetues të jetë i pranueshëm, ai duhet që sipas nenit 71/a (b) të Ligjit nr. 8577 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" të paraqitet brenda katër muajve nga konstatimi i shkeljes. Në rastin e ankuesve, ky afat ka kaluar dhe ata argumentojnë se nuk parashikohen përjashtime nga afati. Më tej ata argumentojnë se ankimi kushtetues nuk është një mjet efektiv, në rastin e tyre, pasi Gjykata Kushtetuese nuk ka ndonjë kompetencë konkrete për të rivendosur të drejtat e viktimave, por vetëm për të shfuqizuar vendimet gjyqësore, e për këtë arsye Gjykata nuk mund t'u siguronte atyre një mjet efektiv, d.m.th., Gjykata nuk ka kompetencë të urdhërojë Zyrën e Regjistrimit të Gjendjes Civile për regjistrimin e tyre.

2.9 Ankuesit pretendojnë se për arsyet e përshkruara më sipër nuk ka mjete juridike efektive në dispozicion të tyre në shtetin palë, pasi nuk ekziston asnjë procedurë sipas legjislacionit të shtetit palë që mund t'u sigurojë atyre një regjistrim "të menjëhershëm" të lindjes, siç kërkohet nga neni 24 (2), lexuar në lidhje me nenin 2 (2-3) të Paktit. Ata gjithashtu parashitrojnë se kërkesa e tyre për të ndërmarrë procese gjyqësore të gjata dhe të pasigurta vetëm do të minonte më tej të drejtën e tyre për regjistrim të menjëhershëm të lindjes. Për më tepër, ata vërejnë se shkelja e të drejtave të tyre rezulton pjesërisht nga dështimi i shtetit palë për të bashkëpunuar efektivisht me homologët e tyre në Greqi.

Ankesa

3.1 Ankuesit pretendojnë se duke mos regjistruar lindjet e tyre, shteti palë ka shkelur të drejtat e tyre sipas neneve 16, 17, 24 (1-3), 25 dhe 26 të Paktit.

3.2 Ankuesit pretendojnë një shkelje të të drejtave të tyre sipas nenit 24 (2) të Paktit, pasi Shteti palë nuk ka proceduar me regjistrimin e lindjes së tyre, pasi ata nuk ishin në gjendje të paraqitnin një certifikatë lindjeje nga Greqia, në formën e e kërkuar nga legjislacioni i Shtetit Palë, pra certifikatë të legalizuar, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Ata pretendojnë se nuk mund të paraqesin një dokument të tillë pasi certifikatat e lëshuara nga autoritetet greke për lindjet e tyre janë të paplota dhe nuk përmbajnë emrat e tyre. Kjo për shkak të statusit të padokumentuar të prindërve të tyre në Greqi në kohën e lindjes së tyre. Ankuesit parashitrojnë se termi "menjëherë", parashikuar në nenin 24 (2) vendos një kërkesë të veçantë për autoritetet, të cilën shteti palë nuk po e përmbush në rastin e tyre. Autoritetet e shtetit palë janë të vetëdijshme se ankuesit nuk mund të paraqesin një certifikatë lindjeje greke në përputhje me kërkesat e

³ Ankuesit i referohen vendimit nr.41-2017-4172 (1522), datë 5 dhjetor 2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, objekt i të cilit ishte plotësimi i të dhënave për një person të lindur në Greqi. Gjykata deklaroi se pasaktësia e një certifikate lindjeje dhe një deklaratë lindjeje të lëshuar në Greqi nuk përbënte një rast ku plotësimi i të dhënave të certifikatës së lindjes mund të jepej nga Gjykata. Gjykata e Apelit e la në fuqi vendimin në apel. Ankuesit i referohen edhe një vendimi të Gjykatës së Rrethit Shkodër, datë 15 shkurt 2018, vendimi nr. 572, në të cilin Gjykata refuzoi një kërkesë për të konfirmuar lindjen e dy fëmijëve të lindur në Belgjikë, pasi Gjykata konstatoi se prindërit duhej të dorëzonin certifikatat belge të lindjes në zyrën e gjendjes civile shqiptare për të regjistruar lindjen e fëmijëve.

legjislacionit të shtetit palë. Këmbëngulja për një dokument të tillë në rastin e ankuesve shkakton vonesa arbitrare në regjistrim dhe i vë ata në rrezik të pashtetësisë, duke i privuar ata nga të drejtat themelore si e drejta për arsim dhe shëndetësi. Kërkesa sipas legjislacionit vendas që fëmijët e prindërve shqiptarë të lindur jashtë vendit, duhet të paraqesin një certifikatë lindjeje të legalizuar dhe mungesa e përjashtimeve për të gjithë ata që ndodhen në pozitën e ankuesve, të cilët nuk janë në gjendje të marrin një dokument të tillë, e bën regjistrimin të pamundur për një periudhë të pacaktuar, gjë që bie në kundërshtim të hapur me kërkesën e përcaktuar në termin "menjëherë" të nenit 24 (2) të Paktit. Ankuesit vërejnë se në momentin e paraqitjes së ankesës së tyre, ata ishin përkatësisht katër dhe 15 vjeç dhe ende të paregjistruar, gjë që është qartësisht e papajtueshme me dispozitat e Paktit.

3.3 Ankuesit pretendojnë se duke mos regjistruar lindjet e tyre, shteti palë ka shkelur, gjithashtu të drejtën e tyre për të fituar një shtetësi sipas nenit 24 (3) të Paktit. Ata theksojnë se sipas nenit 7 të Ligjit për Shtetësinë, çdo individ i lindur nga një ose dy prindër me shtetësi shqiptare, fiton automatikisht shtetësinë shqiptare. Megjithatë, në praktikë, shtetësia shqiptare njihet vetëm në bazë të regjistrimit të lindjes së një fëmije. Për shkak të legjislacionit të shtetit palë, ankuesit pretendojnë se ata nuk janë në gjendje të regjistrojnë lindjen e tyre dhe për këtë arsye janë në rrezik të pashtetësisë. Ata pretendojnë se janë ligjërisht të padukshëm dhe se kjo situatë mund të zgjasë për një kohë të pacaktuar.

3.4 Më tej, ankuesit pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre sipas nenit 24 (1) të Paktit. Ata theksojnë se mosregjistrimi i menjëhershëm i lindjeve të tyre është një masë neutrale përsa i përket racës, por që ka një ndikim joproporcional te romët⁴. Ankuesit vënë në dukje se Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) ofron shërbime ligjore falas në lidhje me regjistrimin e lindjeve pa dallim race apo etnie; por nuk është një organizatë e krijuar posaçërisht për të ofruar shërbime për romët. Megjithatë, pavarësisht nga përqindja e vogël e romëve në shtetin palë, e vlerësuar në 0,29% deri në 3,5% të popullsisë, romët përbëjnë më shumë se gjysmën e familjeve që kërkojnë ndihmë nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS). Ankuesit vënë në dukje se fëmijët që nuk janë në gjendje të regjistrojnë lindjen e tyre pranë autoritetet shtetërore të shtetit palë janë të privuar nga një sërë të drejtash themelore, duke përfshirë: (a) të drejtën për kujdes shëndetësor, pasi fëmijët që nuk janë regjistruar nuk mund të regjistrohen për sigurim shëndetësor dhe si rezultat nuk gëzojnë akses në shërbime shëndetësore falas ose me kosto të reduktuar, në shtetin palë; (b) e drejta për arsimim - pasi shkollat në shtetin palë në përgjithësi presin që prindërit të paraqesin dokumente regjistrimi, duke përfshirë një certifikatë lindjeje për t'u regjistruar në shkollë. Ndërkohë që Ministria e Arsimit ka nxjerrë një urdhër që kërkon që shkollat të regjistrojnë fëmijët që nuk kanë certifikatë lindjeje, shumë prindër nuk janë në dijeni të urdhrin dhe në disa raste shkollat nuk zbatojnë urdhrin, dhe kështu fëmijët nuk kanë mundësi për të ndjekur shkollën; (c) aksesi në drejtësi dhe e drejta për mbrojtjen e jetës familjare. Kur fëmijët janë të paregjistruar, gjykatat, në rastin e shqyrtimit të çështjeve të të drejtës familjare nuk e njohin ekzistencën e tyre sipas legjislacionit të të drejtës së familjes. Kjo mund të ketë ndikime të ndryshme si p.sh. në rast divorci, dhunë në familje, vdekje të një ose më shumë prindërve ose situata të ngjashme ku gjykatat kombëtare thjesht nuk marrin asnjë vendim ose nuk do të lëshojnë asnjë urdhër për të drejtat ose të ardhmen e këtyre fëmijëve; dhe (d) mbrojtja sociale pasi familjet e fëmijëve të paregjistruar nuk janë në gjendje të sigurojnë akses për përfitimet e fëmijëve, gjë që ka një ndikim veçanërisht të fortë në familjet rome që priren të jenë më të varfra për shkak të përjashtimit historik.

3.5 Më tej, ankuesit theksojnë se sipas raportit të UNHCR-së 'Harta e popullsisë në rrezik të pashtetësisë në Shqipëri'⁵ 1,031 persona ishin në rrezik të pashtetësisë në Shtetin palë në vitin 2018, kryesisht për shkak të vështirësive për të konfirmuar shtetësinë e tyre. Numri, ka të ngjarë, të jetë më i lartë, pasi personat në rrezik të pashtetësisë shpesh

⁴ Ankuesit i referohen CERD-së, vëzhgimeve përmbyllëse mbi Shqipërinë, CERD/C/ALB/CO/5-8, paragrafi 7, 14 shtator 2011 dhe raportit të UNHCR-së "Harta e popullsisë në rrezik të pashtetësisë në Shqipëri", maj 2018.

⁵ Raporti i UNHCR 'Harta e Popullsisë në Rrezik të Pashtetësisë në Shqipëri', f.8.

mbeten të padukshëm dhe janë të vështirë për t'u identifikuar. 97% e të regjistruarve në rrezik të pashtetësisë në Shqipëri janë fëmijë. Shkaqet kryesore të raportuara janë: të lindurit jashtë territorit shqiptar (53%), të lindurit nga prindër të pamartuar (12%), të lindurit në shtëpi (10%) dhe të lindurit në spital ose maternitete që kanë të dhëna të pasakta personale për nënën (9%). Në mesin e atyre në rrezik të pashtetësisë që kanë lindur jashtë Shqipërisë, shumica kanë lindur në Greqi. Përkundër faktit se komunitetet rome dhe egjiptiane përfaqësojnë vetëm 0.4% dhe 3.3% të popullsisë së përgjithshme shqiptare, ata përbëjnë gjysmën e rasteve të identifikuara të fëmijëve në rrezik të pashtetësisë dhe në këtë mënyrë janë të prekur në mënyrë disproporcionale nga ky fenomen⁶.

3.6 Gjithashtu, ankuesit pretendojnë se janë shkelur të drejtat e tyre sipas neneve 16, 17, 25 dhe 26 të Paktit. Ata argumentojnë se për shkak të statusit të tyre si persona ligjërish të padukshëm në shtetin palë, ata nuk janë në gjendje të gëzojnë të drejtën për t'u njohur si person përpara ligjit, të drejtën e tyre si qytetarë për të marrë pjesë në jetën publike dhe të drejtën e tyre për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë sipas ligjit. Lidhur me pretendimin e tyre sipas nenit 26 të Paktit, ata argumentojnë se e drejta e përmendur është shkelur për të njëjtat arsye siç janë përcaktuar në lidhje me pretendimet e tyre sipas nenit 24 (1).

Pretendimet e shtetit palë mbi themelin e çështjes

4. Më 18 korrik 2021, shteti palë paraqiti vërejtjet e tij mbi komunikimin duke ofruar informacion mbi legjislacionin e sapomiratur në shtetin palë. Shteti palë vëren se në dhjetor 2018 hynë në fuqi ndryshimet e Ligjit për Gjendjen Civile. Ai vë në dukje se disa nga ndryshimet në legjislacionin përfshijnë: (a) Regjistrimi i lindjes së fëmijëve të lindur jashtë territorit të shtetit palë nga prindër shqiptarë do të kryhet nga shërbimi i gjendjes civile të vendit të lindjes. Kur kjo nuk është e mundur, përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit palë në vendin e lindjes regjistrojnë lindjen e fëmijës. (b) Të gjitha institucionet shëndetësore, publike apo private, që kanë të drejtë të vërtetojnë një lindje janë të detyruara të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile dokumentacionin për çdo fëmijë të lindur në institucionet e tyre. (c) Në rastet kur të dhënat janë të paplota, zyra e gjendjes civile është e detyruar të regjistrojë lindjet në regjistra të përkohshëm ose kalimtarë, të cilat do t'u sigurojnë fëmijëve akses në shërbimet e kujdesit social, arsimin dhe shëndetësi gjatë plotësimit të të dhënave. Zyra do të ndihmojë edhe prindërit në marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e të dhënave. d) Nëse lindja e një fëmije nuk regjistrohet brenda 60 ditëve nga data e lindjes, zyra e gjendjes civile duhet të informojë njësinë përkatëse të shërbimit social për mbrojtjen e fëmijëve, e cila duhet të marrë masa konkrete për vlerësimin e situatës dhe regjistrimin e lindjes nga zyra e gjendjes civile. Shteti palë vëren se me ndryshimet në legjislacionin e tij të brendshëm, zyrat e gjendjes civile janë të detyruara të sigurojnë që asistencën në regjistrimin e lindjeve t'u ofrohet qytetarëve që posedojnë certifikata lindjeje jo të plota.

Komentet e Ankuesve ndaj vërejtjeve të Shtetit Palë

5. Më 22 prill 2022, ankuesit paraqitën komentet e tyre ndaj vërejtjeve të shtetit palë. Ankuesit vërejnë se ka pasur përmirësime të rëndësishme në legjislacionin në lidhje me regjistrimin e lindjeve në shtetin palë, por ata argumentojnë se ka ende nevojë për përmirësimin e pajisjeve teknike dhe njohurive ligjore në qendrat shëndetësore në shtetin palë, për të siguruar që lindja e një fëmije të regjistrohet brenda një periudhe të shkurtër kohore. Ankuesit vërejnë se legjislacioni i ri është miratuar për të lehtësuar aksesin në regjistrimin e lindjeve për fëmijët e lindur jashtë territorit të shtetit palë. Megjithatë, ata theksojnë se sipas raportimeve, në shumicën e rasteve regjistrimi kërkon ende procedura gjyqësore, gjë që shkakton vonesa në regjistrimin e lindjeve. Vështirësitë lindin, veçanërisht, kur një lindje nuk shoqërohet me dokumentet që autoritetet kërkojnë të paraqiten, të tilla si raporte mjekësore, dokumente identiteti të njërit ose të dy prindërve,

⁶ Ibid.

ose kur prindërit nuk paraqiten në zyrën e regjistrimit brenda afatit të caktuar.

Çështjet dhe procedurat përpara Komitetit

Shqyrtimi i pranueshmërisë së ankesës

6.1 Përpara se të shqyrtojë çdo pretendim të përfshirë në një komunikim, Komiteti duhet të vendosë, në përputhje me rregullin 97 të rregullores së tij të procedurës, nëse komunikimi është i pranueshëm sipas Protokollit Fakultativ.

6.2 Komiteti ka konstatuar, siç parashikohet në nenin 5 (2) (a) të Protokollit Fakultativ, se e njëjta çështje nuk po shqyrtohet sipas një procedure tjetër hetimi ose shqyrtimi ndërkombëtare.

6.3 Komiteti vëren se lindja e ankuesit të dytë dhe të tretë ka ndodhur në vitin 2002, d.m.th., përpara hyrjes në fuqi të Protokollit Fakultativ për shtetin palë. Komiteti përsërit jurisprudencën e tij se shkeljet e prezumuara të Paktit që kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të Protokollit Fakultativ, për një shtet të caktuar palë, mund të shqyrtohen nga Komiteti nëse ato shkelje vazhdojnë pas asaj date ose vazhdojnë të kenë efekte që në vetvete përbëjnë shkelje të Paktit, ose nëse shteti palë pohon një shkelje të tillë⁷. Në rastin konkret, Komiteti shqyrton pretendimet e ankuesve se shkeljet e të drejtave të tyre kanë pasur efekt të vazhdueshëm pas hyrjes në fuqi të Protokollit Fakultativ, me rrezikun e pashtetësisë për shkak të dështimit nga shteti palë për të regjistruar lindjet e tyre, duke i privuar gjithashtu ata nga aksesin në të drejtat themelore si arsimit dhe shëndetësia. Komiteti vëren më tej se shteti palë nuk e ka kundërshtuar pranueshmërinë e këtij komunikimi. Për rrjedhojë Komiteti arrin në përfundimin se nuk ka pengese *ratione temporis*, sipas nenit 3 të Protokollit Fakultativ, të shqyrtojë ankesën aktuale.

6.4 Komiteti vë në dukje parashtrimin e ankuesve se shteti palë nuk parashikonte asnjë mjet juridik efektiv në lidhje me pretendimet e ngritura në komunikim. Komiteti vëren se shteti palë nuk ka identifikuar ndonjë mjet juridik të brendshëm që do të ishte në dispozicion të ankuesve dhe as nuk e kundërshtuan pranueshmërinë e këtij komunikimi. Prandaj Komiteti arrin në përfundimin se neni 5 (2) (b) i Protokollit Fakultativ, nuk e ndalon Komitetin të shqyrtojë ankesën aktuale.

6.5 Komiteti trajtoi pretendimet e ankuesve se të drejtat e tyre sipas neneve 17 dhe 25 të Paktit janë shkelur për shkak të statusit të tyre si persona ligjërisht të padukshëm në shtetin palë, është shkelur e drejta e tyre për jetën familjare dhe e drejta për të marrë pjesë në jetën publike është shkelur. Megjithatë, Komiteti vëren se ankuesit nuk kanë paraqitur ndonjë informacion apo argument specifik se si ata personalisht janë ndikuar negativisht në lidhje me pretendimet e tyre në këtë drejtim. Kështu, Komiteti i gjen pretendimet e ankuesve sipas neneve 17 dhe 25 të Konventës si pamjaftueshmërisht të bazuara dhe për këtë arsye të papranueshme sipas nenit 2 të Protokollit Fakultativ.

6.6 Megjithatë, Komiteti gjykon se palët kanë vërtetuar mjaftueshëm pjesën e mbetur të pretendimeve të tyre. Prandaj, Komiteti e deklaron komunikimin të pranueshëm për sa i përket pretendimeve të palëve sipas neneve 16, 24 (1-3) dhe 26 të Paktit dhe vazhdon me shqyrtimin e çështjes në themel.

Shqyrtimi i themelit të çështjes

7.1 Komiteti e ka shqyrtuar komunikimin në dritën e të gjithë informacionit të paraqitur nga palët, në përputhje me nenin 5 (1) të Protokollit Fakultativ.

7.2 Komiteti vëren pretendimet e ankuesve se duke mos regjistruar lindjet e tyre, shteti palë ka shkelur të drejtat e tyre sipas neneve 16, 24 (1-3) dhe 26 të Paktit.

7.3 Komiteti rithekson se, sipas nenit 24, çdo fëmijë ka të drejtë për masa të veçanta

⁷ Shih për shembull, *Kouidis kundër Greqisë* (CCPR/C/86/D/1070/2002), para. 6.3 dhe *Quliyev kundër Azerbajxhanit* (CCPR/C/112/D/1972/2010), para. 8.3.

mbrojtjeje për shkak të statusit të tij si i mitur⁸. Ai thekson se parimi i interesit më të mirë për fëmijën është një element parësor në të gjitha vendimet që kanë pasoja për fëmijën, dhe kjo përbën një pjesë integrale të të drejtës së çdo fëmije për masat e mbrojtjes, siç kërkohet sipas nenit 24 (1)⁹. Komiteti vëren se sipas nenit 24 (2), çdo fëmijë ka të drejtë të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe të ketë një emër. Në lidhje me këtë, Komiteti vëren se regjistrimi i lindjes është regjistrimi i vazhdueshëm, i përhershëm dhe universal në regjistrin e gjendjes civile, të faktit dhe karakteristikave të lindjes, në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare, që përcakton ekzistencën e një personi sipas ligjit dhe hedh themelet për mbrojtjen e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Si i tillë, ai është një mjet themelor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut¹⁰.

7.4 Më tej, Komiteti thekson se në kontekstin e mbrojtjes që duhet t'u jepet fëmijëve, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet, të drejtës së çdo fëmije për të fituar një shtetësi, siç parashikohet në nenin 24 (3) të Paktit, qëllimi i të cilit është të parandalojë që një fëmijë t'i ofrohet më pak mbrojtje nga shoqëria¹¹. Prandaj, shteteve palë u kërkohet të miratojnë çdo masë të përshtatshme, si brenda dhe në bashkëpunim me shtetet e tjera, për të siguruar që çdo fëmijë të ketë një shtetësi në momentin e lindjes. Në lidhje me këtë, asnjë diskriminim në lidhje me fitimin e shtetësisë nuk duhet të pranohet sipas ligjit të brendshëm si midis fëmijëve të ligjshëm dhe fëmijëve të lindur jashtë martese ose nga prindër pa shtetësi ose bazuar në statusin e shtetësisë së njërit ose të dy prindërve¹². Komiteti përmend jurisprudencën e tij se për shkak të vështirësive që shpesh lindin kur përcaktohet nëse një individ ka fituar një shtetësi, barra e provës duhet të ndahet ndërmjet individit dhe autoriteteve shtetërore të shtetit palë për të marrë prova dhe për të vërtetuar faktet nëse një individ do të ishte ndryshe pa shtetësi¹³. Komiteti vëren se ndërsa regjistrimi i lindjes nuk i jep në vetvete shtetësinë një fëmije, është thelbësore të sigurohet e drejta e çdo fëmije për të fituar një shtetësi, pasi ai përbën një formë të rëndësishme të provës së lidhjes midis një individi dhe shtetit. Ai dokumenton se ku ka lindur një fëmijë dhe cilët janë prindërit e fëmijës, duke siguruar kështu prova të rëndësishme nëse një fëmijë mund të fitojë shtetësinë në bazë të vendit të lindjes ose prejardhjes¹⁴.

7.5 Në rastin konkret, Komiteti vë në dukje pretendimet e ankuesve se të drejtat e tyre sipas nenit 24 (2-3) të Paktit janë shkelur nga dështimi i autoriteteve të shtetit palë për të regjistruar lindjen e tyre. Ai vë në dukje argumentin e tyre se prindërit e tyre nuk ishin në gjendje të regjistronin lindjet në organet shtetërore të shtetit palë pasi ata nuk ishin në gjendje të dorëzonin certifikatat greke të lindjes në formën e kërkuar sipas legjislacionit të shtetit palë, për shkak të statusit të prindërve pa dokumente në Greqi në kohën e lindjes së tyre. Komiteti, më tej, vë në dukje argumentin e ankuesve se autoritetet shtetërore të shtetit palë ishin në dijeni të faktit që prindërit e tyre nuk ishin në gjendje të paraqisnin certifikata lindjeje në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shtetit palë, por megjithatë këmbëngulën në paraqitjen e dokumenteve të përmendura. Kjo, pa përcaktuar asnjë përjashtim për personat në situata të veçanta cenueshmërie siç janë ankuesit, duke vonuar në mënyrë arbitrare regjistrimin e lindjeve të tyre, duke i vënë ata në rrezik të pashtetësisë dhe duke i privuar nga të drejtat themelore, siç është e drejta për arsim dhe shëndetësi. Komiteti vë në dukje informacionin e shtetit palë se legjislacioni vendas për regjistrimin e lindjeve u ndryshua në dhjetor 2018, kur ndryshimet në Ligjin për Gjendjen Civile hynë në fuqi. Ai vëren informacionin e shtetit palë se ndryshimet legjislative kishin për qëllim lehtësimin e regjistrimit të lindjeve në shtetin palë, duke përfshirë personat e lindur jashtë territorit të shtetit palë dhe të cilëve mund t'u mungojnë certifikatat formale të lindjes të kërkuara sipas legjislacionit të mëparshëm. Komiteti vë në dukje, gjithashtu, informacionin e shtetit palë se sipas legjislacionit të ndryshuar, zyrat e gjendjes civile janë të detyruara të sigurojnë asistencë në regjistrimin e lindjeve për qytetarët që posedojnë certifikata lindjeje jo të plota.

⁸ Koment i përgjithshëm Nr. 17 (1989) për të Drejtat e Fëmijëve, para. 4; dhe *Mònaco de Gallicchio kundër Argjentinës* (CCPR/C/53/D/400/1990), para. 10.5.

⁹ *Bakhtiyari dhe Bakhtiyari kundër Australisë* (CCPR/C/79/D/1069/2002), para. 9.7.

¹⁰ OHCHR, A/HRC/27/22, 'Regjistrimi i lindjes dhe e drejta e kujtdo për t'u njohur kudo si person para ligjit', para. 4.

¹¹ Koment i përgjithshëm nr. 17, para 8.

¹² Ibid.

¹³ *Zhao kundër Holandës* (CCPR/C/130/D/2918/2016), para. 8.3.

¹⁴ A/HRC/27/22, para. 24.

7.6 Kështu, Komiteti vëren dhe mirëpret përmirësimet në legjislacionin e shtetit palë në lidhje me regjistrimin e lindjeve. Megjithatë, ai vëren se nuk është dhënë asnjë informacion për gjendjen e palëve, apo nëse me ndryshimet legjislative në Ligjin për gjendjen civile lindjet e tyre janë regjistruar në gjendjen civile. Pavarësisht nëse ankuesit kanë mundur më pas të regjistrojnë lindjet e tyre, Komiteti megjithatë vë në dukje se në kohën e paraqitjes së ankesës, ata ishin përkatësisht katër dhe 15 vjeç, dhe lindja e tyre ishte ende e paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile në shtetin palë, duke mos i lejuar ankuesit të kenë akses në të drejtat bazë si sigurimi shëndetësorë, regjistrimi në shkollë, dhe sigurimet shoqërore dhe duke i ekspozuar ata ndaj rrezikut të pashtetësisë.

7.7 Komiteti thekson se në nenin 4 (2) të Protokollit Fakultativ nënkuptohet që shteti palë ka për detyrë të shqyrtojë me mirëbesim të gjitha pretendimet për shkelje të Paktit, të ngritura kundër tij dhe përfaqësuesve të tij dhe t'i sigurojë Komitetit informacionin që disponon. Në rastet kur pretendimet vërtetohen nga prova të besueshme të paraqitura nga pala dhe kur sqarimi i mëtejshëm varet nga informacioni që është vetëm në duart e shtetit palë, Komiteti mund t'i konsiderojë pretendimet e një pale si të vërtetuara në mungesë të provave bindëse ose shpjegimeve për të kundërtën nga shteti palë¹⁵. Në rastin konkret, Komiteti vëren se shteti palë nuk ka kundërshtuar asnjë nga pretendimet e palëve siç parashikohet në nenin 24 (2-3) të Paktit. Në mungesë të një përgjigjeje nga shteti palë në lidhje me këtë, Komiteti vlerëson pretendimet e palëve dhe konstaton se shteti palë nuk ka ushtruar kujdesin e duhur në përmbushjen e detyrimit të tij pozitiv për të ndihmuar palët në regjistrimin e lindjes së tyre në regjistrin e gjendjes civile duke përcaktuar kështu shtetësinë e tyre, në shkelje të të drejtave të tyre sipas neneve 24 (2-3) të Konventës.

7.8 Në vazhdim, Komiteti vlerëson pretendimin e ankuesve se mosregjistrimi i lindjeve përbën diskriminim bazuar në përkatësinë etnike në shkelje të të drejtave të tyre sipas nenit 24 (1) dhe 26 të Paktit. Komiteti thekson se Pakti parashikon që fëmijët duhet të mbrohen nga diskriminimi për çfarëdo arsye si raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, origjina kombëtare ose sociale, prona ose lindja. Në lidhje me këtë, Komiteti vëren se, ndërsa mosdiskriminimi në gëzimin e të drejtave të parashikuara në Pakt buron gjithashtu, në rastin e fëmijëve, nga neni 2 dhe barazia e tyre para ligjit nga neni 26, klauzola e mosdiskriminimit që përmban neni 24 lidhet veçanërisht me masat e mbrojtjes të përmendura në atë dispozitë¹⁶. Komiteti rikujton më tej se komenti i përgjithshëm nr. 18 e përkufizon diskriminimin si “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, fenë, opinionet politike ose të tjera, origjina kombëtare ose shoqërore, pasuria, lindja ose çdo status tjetër, dhe që ka qëllim ose efekt të anulojë ose cenojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive në mënyrë të barabartë nga të gjithë individët¹⁷. Komiteti rikujton se ndalimi i diskriminimit zbatohet si për sferën publike ashtu edhe për atë private dhe se një shkelje e të drejtës për mosdiskriminim mund të rezultojë nga një rregull ose masë që në dukje është neutrale ose nuk ka ndonjë qëllim për të diskriminuar, por ka një efekt diskriminues¹⁸. Megjithatë, jo çdo dallim, përjashtim ose kufizim i bazuar në arsyet e listuara në Pakt përbën diskriminim, për sa kohë që bazohet në kritere të arsyeshme dhe objektive, në ndjekje të një qëllimi që është legjitim sipas Paktit¹⁹.

7.9 Në rastin konkret, Komiteti vëren se pretendimi i ankuesve se legjislacioni i shtetit palë për regjistrimin e lindjeve ishte një masë neutrale përsa i përket paraqitjes së jashtme, por ai kishte një ndikim joproporcional mbi romët, pasi ata argumentuan se romët, si në situatën e prindërve të tyre, kanë më shumë gjasa të shpërngulen në Greqi në mënyrë të parregullt për shkak të varfërisë së tyre të jashtëzakonshme në Shqipëri për shkak të përjashtimit historik, që duket si shënjestrim më i rregullt për romët. Romët përballen me pengesa që i pengojnë ata të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e një lindjeje. Në lidhje me këtë pretendim, Komiteti vëren se sipas

¹⁵ Shih për shembull, *Purna kundër Nepalit* (CCPR/C/119/D/2245/2013), para. 12.2 dhe *V.M. kundër Sri Lankës* (CCPR/C/137/D/2406/2014), para. 8.3.

¹⁶ Koment i përgjithshëm nr. 17, para 5.

¹⁷ Koment i përgjithshëm Nr. 18 (1989) për mosdiskriminim, para. 7.

¹⁸ *Althammer et al. kundër Austrisë* (CCPR/C/78/D/998/2001), para. 10.2.

¹⁹ *O'Neill dhe Quinn kundër Irlandës* (CCPR/C/87/D/1314/2004), para. 8.3; *Yaker kundër Francës* (CCPR/C/123/D/2747/2016), para. 8.14; *Hebbadj kundër Francës* (CCPR/C/123/D/2807/2016), para. 7.14; dhe *Genero kundër Italisë* (CCPR/C/128/D/2979/2017), para. 7.3.

informacionit të dhënë nga ankuesit, duke iu referuar një raporti të UNHCR-së të vitit 2018, fëmijët nga komunitetet rome dhe egjiptiane regjistrohen në mënyrë disproporcionale dhe vlerësohen si të rrezikuar nga pashtetësia në shtetin palë, pasi pavarësisht se përfaqësonin vetëm 0.4% dhe 3.3% të popullsisë totale shqiptare, ata përbëjnë gjysmën e fëmijëve në rrezik të rasteve të regjistruara në vend. Komiteti vëren se shteti palë nuk ka paraqitur asnjë informacion që hedh poshtë pohimin e palëve në lidhje me këtë pretendim, as nuk ka paraqitur ndonjë argument për efektin se legjislacioni i shtetit palë është bazuar në kritere të arsyeshme dhe objektive dhe në ndjekje të një qëllimi që është legjitim sipas Paktit. Në mungesë të një shpjegimi nga shteti palë në lidhje me këtë, Komiteti vlerëson pretendimet e palëve dhe konstaton se faktet e përshkruara përbëjnë shkelje të të drejtave të palëve sipas neneve 24 (1) dhe 26 të Paktit.

7.10 Komiteti vë në dukje pretendimin e ankuesve se për shkak të statusit të tyre si persona ligjërish të padukshëm në shtetin palë, ata nuk janë në gjendje të gëzojnë të drejtën për t'u njohur si person para ligjit, duke shkelur të drejtat e tyre sipas nenit 16 të Paktit. Komiteti vëren se e drejta për njohje përpara ligjit nënkupton aftësinë për të qenë mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve²⁰ dhe për këtë arsye është themelore për të gjitha të drejtat pasi njohja e personalitetit juridik është një parakusht i domosdoshëm për të gjitha të drejtat e tjera të individit. Komiteti kujton komentin e tij të përgjithshëm nr. 17, në të cilin vuri në dukje se dispozitat e nenit 24 (2) duhet të interpretohen si të lidhura ngushtë me dispozitën në lidhje me të drejtën për masa të veçanta mbrojtjeje dhe se ajo është krijuar për të nxitur njohjen e personalitetit juridik të fëmijës²¹. Qëllimi i detyrimit për të regjistruar fëmijët pas lindjes është të reduktojë, për shembull, rrezikun e rrëmbimit, shitjes ose trafikimit të fëmijëve, ose të llojeve të tjera të trajtimit që janë të papajtueshme me gëzimin e të drejtave të parashikuara në Pakt²². Përmbushja e së drejtës për t'u regjistruar në lindje dhe për t'u njohur si person para ligjit është e lidhur ngushtë dhe një parakusht i gëzimit dhe realizimit të shumë të drejtave të tjera, me të drejta socio-ekonomike, ku në rrezik të veçantë vihet e drejta për përfitime shëndetësore dhe e drejta për arsim dhe kur regjistrimi i lindjes nuk kryhet sistematikisht, mbrojtja e fëmijëve në këtë mënyrë rrezikohet²³. Mosregjistrimi i lindjes ka pasoja të thella për gëzimin e të drejtave të fëmijëve në lidhje me mbrojtjen, kombësinë, aksesin në shërbimet sociale dhe shëndetësore dhe arsimin²⁴.

7.11 Në rastin konkret, Komiteti thekson pretendimet e ankuesve se për shkak të statusit të tyre si persona ligjërish të padukshëm, ata ndodhen në një gjendje të harresës ligjore dhe si rrjedhim nuk ishin në gjendje të ndiqnin shkollën ose të aksesonin shërbimet sociale dhe shëndetësore (para. 3.4). Komiteti vëren se komentet e shtetit palë në lidhje me ndryshimet e vitit 2018 në Ligjin për Gjendjen Civile (para. 4) nuk ofrojnë ndonjë argument bindës që të hedhë poshtë pretendimet e ankuesve në këtë drejtim. Komiteti konsideron se duke mos regjistruar faktin e lindjes dhe duke mos njohur, kështu, personalitetin e tyre juridik, shteti palë ka shkelur të drejtat e ankuesve sipas nenit 16 të Paktit.

8. Komiteti, duke vepruar sipas nenit 5 (4) të Protokollit Fakultativ, është i mendimit se faktet përpara tij zbulojnë një shkelje nga shteti palë të të drejtave të ankuesve sipas neneve 16, 24 (1-3) dhe 26 të Paktit.

9. Në bazë të nenit 2 (3) (a) të Paktit, shteti palë është i detyruar t'u sigurojë ankuesve një mjet juridik efektiv. Kjo kërkon që shteti të korrigjojë plotësisht shkeljet ndaj individëve, të drejtat e të cilëve të parashikuara nga Pakti janë shkelur. Për këtë arsye, shteti palë është i detyruar të sigurojë që lindja e fëmijëve të ankuesve të regjistrohet menjëherë në regjistrin e gjendjes civile, nëse kjo nuk është bërë, duke marrë parasysh gjetjet e Komitetit në këtë raport dhe t'u japë atyre kompensimin e duhur. Gjithashtu, shteti palë është i detyruar të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të

²⁰ Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut, *Vajzat Yean dhe Bosico kundër Republikës Dominikane*, Pretendimet paraprake, themeli, dëshmipërblimet dhe shpenzimet, vendimi i 8 shtatorit 2005, para. 176-178.

²¹ Komenti i përgjithshëm nr. 17, para. 7.

²² Ibid.

²³ A/HRC/27/22, para. 3. Shih gjithashtu Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm nr. 7 (2005) mbi Zbatimin e të drejtave të fëmijëve në fëmijërinë e hershme, para. 25.

²⁴ A/HRC/27/22, para. 18.

parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen, duke përfshirë garancinë që legjislacioni i tij për regjistrimin e lindjeve, si dhe zbatimin e tij, të jetë në përputhje me detyrimet e shtetit palë sipas neneve 16, 24 (1-3) dhe 26 të Paktit.

10. Duke pasur parasysh se, duke u bërë palë në Protokollin Fakultativ, shteti palë ka pranuar juridiksionin e Komitetit për të përcaktuar nëse ka pasur shkelje të Paktit dhe se, në përputhje me nenin 2 të Paktit, shteti palë ka marrë përsipër t'u sigurojë të gjithë individëve brenda territorit të tij ose që i nënshtrohen juridiksionit të tij, të drejtat e njohura dhe të parashikuara nga Konventa dhe të sigurojë një zgjidhje efektive dhe të ekzekutueshme për shkeljen, kur është përcaktuar se ka ndodhur një shkelje. Komiteti dëshiron që shteti palë, brenda 180 ditëve, të japë informacion në lidhje me masat e marra për të zbatuar opinionet e Komitetit. Gjithashtu, shtetit palë i kërkohet të publikojë opinionet aktuale dhe t'i shpërndajë ato gjerësisht në gjuhën zyrtare të shtetit palë.
